

VENDIM
Nr. 239, datë 20.4.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË KAVAJË

(ndryshuar me VKM nr. 681, datë 6.12.2023; nr. 345, datë 5.6.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 135 011 697 (një miliard e njëqind e tridhjetë e pesë milionë e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nga Bashkia Kavajë, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 227 002 339 (dyqind e njëzet e shtatë milionë e dy mijë e treqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, nga Bashkia Kavajë, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, në masën 713 796 227 (shtatëqind e trembëdhjetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe i transferohet Bashkisë Kavajë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, nga Bashkia Kavajë për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, në masën 192 095 882 (njëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e nëntëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe i transferohet Bashkisë Kavajë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama